

BULETINI 2025



KOMUNA E LIPJANIT



QERSHOR

Kryetari Ahmeti nderon me homazhe martirin Uran Amërllahu



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, ka bërë homazhe dhe ka vendosur buqetë me lule pranë pllakës përkujtimore në Grykën e Shalës, në nderim të 26-vjetorit të rënies së martirit Uran Amërllahu.

Me këtë rast, Kryetari Ahmeti theksoi se Uran Amërllahu, nxënës i shkollës fillore "Ibrahim Banushi" në Shalë, u vra mizorisht nga forcat serbe më 1 qershor të vitit 1999.

"Uranit, forcat serbe ia morën jetën mizorisht më 1 qershor të vitit 1999, pikërisht në Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve. Ai nuk ishte thjesht një fëmijë i pafajshëm që u bë viktimë e luftës, por një simbol i tragjedisë sonë kolektive dhe i çmimit të lartë të lirisë", tha Kryetari z. Imri Ahmeti.

Ai shtoi se kujtimi i Uranit dhe i të gjithë fëmijëve të vrarë gjatë luftës është një amanet i përhershëm për të mos harruar dhe për të kujtuar gjithmonë rrugëtimin tonë drejt lirisë.

Lavdi Uranit dhe të gjithë martirëve të lirisë!

U shënua 1 Qershori – Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve



Nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, dhe me organizim të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, u shënua Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve me një sërë aktivitete të zhvilluara në sheshin "Adem Jashari".

Sheshi u mbush me ngjyra dhe hare, falë pjesëmarrjes së fëmijëve dhe aktiviteteve të shumta që krijuan një atmosferë të jashtëzakonshme në zemër të qytetit.

Urime 1 Qershori – Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve, të gjithë së bashku le të kujdesemi për fëmijët, sepse ata janë e ardhmja jonë!

Kreativiteti i të rinjve u shndërrua në mjet ndërgjegjësimi në një aktivitet të organizuar nga KYC-Kosova dhe Germin, ku përmes muraleve dhe mesazheve motivuese u përcollën qëndrime të qarta kundër bullizmit.



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, mori pjesë në këtë aktivitet, duke shprehur mbështetjen për angazhimin e të rinjve në kauza që synojnë ngritjen e vetëdijes për ndikimin që bullizmi ka në shëndetin mendor.

“Jam i lumtur të shoh kaq shumë të rinj që veprojnë me vetëdije dhe solidaritet. Ky është drejtimi që na jep shpresë”, tha kryetari Ahmeti.

Komuna e Lipjanit mbështet dhe inkurajon çdo iniciativë që promovon vlera pozitive, përfshirje dhe respekt të ndërsjellë në mesin e të rinjve.




Në sallën e Kuvendit të Komunës së Lipjanit, u mbajt debat publik i organizuar nga DPUMM, lidhur me përgatitjet për revidimin e Hartës Zonale.



Në këtë takim mori pjesë edhe Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, i cili theksoi rëndësinë e përfshirjes së qytetarëve në këtë proces dhe i ftoi të gjithë pjesëmarrësit të japin sugjerime konkrete për një planifikim sa më gjithëpërfshirës.

Ndërkohë, drejtori i DPUMM-së, z. Imri Semetishti, prezantoi qëllimin dhe hapat fillestarë të këtij procesi të rëndësishëm për zhvillimin urban të komunës.

Filloi Java e Kulturës në Lipjan me dokumentarin “Kujtimi i Mbuluar”



Në ambientet e Bibliotekës së Qytetit në Lipjan, filloi Java e Kulturës, një seri aktivitesh kulturore që organizohen në kuadër të shënimit të 12 Qershorit, Ditës së Çlirimit, dhe 14 Qershorit, Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Lipjanit.

Aktiviteti i parë i kësaj jave ishte shfaqja e dokumentarit “Kujtimi i Mbuluar – The Covered Memory”, nga autorja Ariana Krasniqi. Dokumentari trajton një tematikë të ndjeshme dhe të thellë, që lidhet me kujtesën kolektive dhe ngjarjet e luftës mbi të kaluarën tonë të përbashkët.

Ftojme të gjithë qytetarët të bëhen pjesë e aktiviteteve të radhës, të cilat do të vazhdojnë deri më 14 Qershor 2025.

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me z. Basri Shabani, Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Policisë në Prishtinë, kanë nënshkruar një marrëveshje trepalëshe me Postën e Kosovës për shpërndarjen e gjobave të trafikut rrugor në adresat e qytetarëve, përmes shërbimeve postare.



Kjo marrëveshje synon të përmirësojë efikasitetin në njoftimin e qytetarëve për kundërvajtjet në komunikacion dhe të lehtësojë qasjen në dokumentet zyrtare. Gjobat do të shpërndahen përmes një shërbimi të sigurt dhe të verifikueshëm të Postës së Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë me Policinë e Kosovës.

Marrëveshja do të jetë në fuqi deri më 31 dhjetor 2027, me mundësi vazhdimi.

Kryetari Ahmeti nderon me homazhe heroin Lulzim Llugiqi



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, ka bërë homazhe dhe ka vendosur buqetë me lule pranë lapidarit të Dëshmorit të Kombit, Lulzim Llugiqi, me rastin e 26-vjetorit të rënies së tij heroike.

Me këtë rast, kryetari Ahmeti theksoi se nderimi për dëshmorët nuk duhet të mbetet vetëm simbolik, por duhet të shndërrohet në përkushtim të vazhdueshëm për ndërtimin dhe zhvillimin e atdheut.

“Nderimi për dëshmorët si Lulzimi nuk duhet të mbetet vetëm simbolik. Ai duhet të shndërrohet në përkushtim konkret për ndërtimin e një atdheu më të zhvilluar, më të drejtë dhe më të bashkuar, ashtu siç e ëndërruan ata,” tha kryetari z. Imri Ahmeti. Pas homazheve, është mbajtur edhe një program përkujtimor në nderim të jetës dhe veprës së dëshmorit Lulzim Llugiqi. Lavdi të përhershme të gjithë atyre që ranë për liri!

Urimi i Kryetarit të Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, me rastin e festës së Kurban Bajramit



Të dashur qytetarë,
Me rastin e festës së Kurban Bajramit,
ju shpreh urimet më të singerta juve dhe familjeve tuaja për shëndet, paqe dhe harmoni.
Kjo festë e shenjtë na kujton rëndësinë e sakrificës, mirësisë dhe solidaritetit. Është një
moment i veçantë për të reflektuar mbi vlerat që na bashkojnë si shoqëri dhe për të forcuar
lidhjet me familjen, miqtë dhe të gjithë ata që na rrethojnë.
Në këto ditë feste, le të ndajmë gëzimin me zemër të hapur, të jemi më afër njëri-tjetrit me
dashuri, mirëkuptim dhe respekt të ndërsjellë.
Të rrisim kujdesin për njëri-tjetrin, dashurinë për familjen dhe përkushtimin ndaj atdheut.
Sepse zhvillimi dhe përparimi i vendit tonë kërkojnë punë të ndershme, përpjekje të
përbashkëta dhe përgjegjësi nga secili prej nesh.
Uroj që Kurban Bajrami të sjellë gëzim e begati në çdo shtëpi, qetësi në çdo zemër dhe
shpresë për një të ardhme më të mirë.
Gëzuar Kurban Bajramin!

Në kuadër të aktiviteteve të Javës së Kulturës, në ambientet e Bibliotekës së Qytetit në Lipjan u mbajt “Ora letrare” me poetë nga Komuna e Lipjanit, si dhe u bë përrurimi i librit të autorit Abdullah Troshupa me titull: “Leksikon i letrarëve të trevës së Lipjanit”.



Ky aktivitet kulturor bashkoi dashamirës të librit dhe fjalës së shkruar, duke vënë në pah kontributin e autorëve vendorë dhe pasurinë e trashëgimisë sonë letrare.

Me këtë rast, Drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, znj. Anila Reçica Llugiqi, theksoi se libri i z. Troshupa është një pasqyrë e vlefshme e krijimtarisë letrare të kësaj treve, dhe përmes këtij botimi jo vetëm që ruajmë kujtesën kulturore, por edhe i japim vlerë brezave që vijnë.

Komuna e Lipjanit do të vazhdojë të mbështesë aktivitete që promovojnë kulturën, artin dhe letërsinë lokale.

U organizua ekspozitë fotografike me temë luftën çlirimtare të popullit shqiptar, e cila u hap në Sheshin “Adem Jashari” në Lipjan.



Ekspozita ofroi një përmbledhje vizuale nga periudha e luftës, përmes fotografive autentike që dëshmojnë sakrificën, qëndresën dhe përpjekjet e popullit tonë për liri.

Me këtë rast, Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, theksoi rëndësinë e ruajtjes së kujtesës historike dhe trashëgimisë sonë kombëtare, si një vlerë të shenjtë që duhet të kultivohet dhe përcillet te gjeneratat e reja.

Ky aktivitet shënon vazhdimin e ngjarjeve kulturore që po mbahen në kuadër të Javës së Kulturës në Lipjan, me qëllim promovimin e vlerave historike.

Edicioni i katërt i Panairit “P-GJASHT 2025”



Me mbështetjen e Komunës së Lipjanit, në kuadër të shënimit të Ditës së Shkollës në SHFMU “Vëllezërit Frashëri”, u mbajt edicioni i katërt i Panairit të Gjuhës, Artit, Shkencës dhe Teknologjisë – “P-GJASHT 2025”, i organizuar nga SHFMU “Vëllezërit Frashëri”.

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, theksoi se ndihet i lumtur që ka pasur mundësinë të mbështesë këtë aktivitet dhe siguroi se përkrahja për iniciativë që nxisin garën e dijes tek nxënësit do të vazhdojë me përkushtim.

“Ky panair është shndërruar tashmë në një traditë të çmuar arsimore për komunën tonë, ku qindra nxënës nga shkollat e Lipjanit dhe më gjerë prezantojnë ide, projekte dhe performanca mbresëlënëse në fushat e gjuhës, artit, shkencës dhe teknologjisë,” u shpreh kryetari Ahmeti. Ai vlerësoi veçanërisht pjesëmarrjen e “Shkencëtarëve të Vegjël”, nxënësve të ciklit fillor, të cilët përmes projekteve të frymëzuara nga natyra, mjedisi dhe jeta e përditshme dëshmuar se pasioni për dijen nuk njih moshë. Kryetari Ahmeti shprehu falënderime të veçanta për organizatorët, drejtorin e shkollës, mësimdhënësit dhe të gjithë nxënësit për angazhimin, përkushtimin dhe energjinë pozitive që e bënë këtë ngjarje kaq të veçantë. Drejtori i SHFMU “Vëllezërit Frashëri”, z. Jakup Bahtiri, falënderoi kryetarin Ahmeti për përkrahjen e vazhdueshme dhe theksoi se ky panair është rezultat i punës së palodhshme të mësimdhënësve dhe nxënësve. Ai gjithashtu ndau një mirënjohje për kryetarin dhe drejtorin e Drejtorisë Komunale të Arsimit për mbështetjen e vazhdueshme.

Komuna e Lipjanit do të vazhdojë të qëndrojë pranë çdo iniciative që synon fuqizimin e arsimit cilësor dhe zhvillimin e potencialit të të rinjve tanë.

Filluan dëgjimet buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026–2028



Komuna e Lipjanit ka nisur procesin e dëgjimeve buxhetore me qëllim të hartimit sa më gjithëpërfshirës të Kornizës Afatmesme Buxhetore për periudhën 2026–2028.

Gjatë organizimit të dëgjimeve mori pjesë edhe Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, i cili theksoi rëndësinë e këtij procesi për përcaktimin e prioriteteve zhvillimore të komunës. Ai u bëri thirrje qytetarëve që të paraqesin kërkesa konkrete, me qëllim që të ndërtohet një buxhet sa më gjithëpërfshirës dhe në përputhje me nevojat reale të lokaliteteve.

Po ashtu, drejtori i Buxhetit dhe Financave, z. Latif Ramadani, në pika të shkurtra elaboroi rëndësinë e dëgjimeve publike dhe rolin që ato luajnë në planifikimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për periudhën 2026–2028. Dëgjimet e para u mbajtën me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Kuvendit Komunal, Komitetit për Politikë dhe Financa, Komitetit për Komunitete dhe komiteteve të tjera, grave dhe shoqatave të grave, organizatave të shoqërisë civile, personave me aftësi të kufizuara, të rinjve dhe shoqatave të të rinjve, klubeve sportive, fermerëve, si dhe qytetarëve nga Lipjani dhe Gadimja.

Ky proces do të vazhdojë edhe në lokalitete të tjera të komunës, me synim përfshirjen sa më të gjerë të qytetarëve në hartimin e buxhetit komunal. Komuna e Lipjanit mbetet e përkushtuar për transparencë, pjesëmarrje qytetare dhe zhvillim të qëndrueshëm!



Vazhdojnë dëgjimet buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026–2028



Komuna e Lipjanit ka vazhduar me mbajtjen e dëgjimeve buxhetore në kuadër të hartimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore për periudhën 2026–2028, me qëllim përfshirjen aktive të qytetarëve në identifikimin e prioriteteve dhe nevojave zhvillimore të lokaliteteve.

Gjatë këtyre takimeve, qytetarëve u është dhënë mundësia të paraqesin propozimet, kërkesat dhe idetë e tyre për projektet që i konsiderojnë të rëndësishme për lokalitetin e tyre.

Drejtori për Buxhet dhe Financa në Komunën e Lipjanit, z. Latif Ramadani, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të drejtpërdrejtë me qytetarët, prezantoi pikat kryesore të buxhetit komunal dhe njëkohësisht potencoi rëndësinë e pjesëmarrjes së qytetarëve në këto takime, me qëllim të harmonizimit të projekteve sipas prioriteteve të tyre.

Komuna e Lipjanit mbetet e përkushtuar për një proces buxhetor gjithëpërfshirës, transparent dhe në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm.

Takimet u mbajtën në Grackë të Vjetër, Dobrajë e Madhe dhe Krojmir



Komuna e Lipjanit ka shënuar 26-vjetorin e Çlirimit me një sërë aktivitete dhe festive, duke përkujtuar një nga datat më të rëndësishme të historisë së saj të re.



Aktivitete nisën në orët e paradites me homazhe pranë shtatores së Komandantit Legjendar Adem Jashari në qytetin e Lipjanit, aty ku nis kujtesa e gjallë e qëndresës sonë kombëtare.

Nën patronatin e Kryetarit të Komunës, z. Imri Ahmeti, në Sallën e Kuvendit u organizua Akademia Soleme në nderim të 12 qershorit, Ditës së Çlirimit, ku morën pjesë përfaqësues të institucioneve, familjarë të dëshmorëve, martirëve dhe qytetarë të shumtë.

Kryetari Ahmeti, në fjalën e tij para të pranishmëve, theksoi rëndësinë historike dhe emocionale të datës 12 qershor për qytetin e Lipjanit dhe për gjithë popullin shqiptar. "Kjo ditë është më shumë se një përvjetor, është një përkujtim i rrugëtimit të lavdishëm drejt lirisë, një reflektim mbi sakrificën e brezave dhe një angazhim për të ardhmen tonë të përbashkët", tha Kryetari Ahmeti.

Ai vlerësoi se liria e qytetit të Lipjanit dhe e Kosovës është rezultat i përpjekjeve të shumta e të përbashkëta, dhe se nuk është arritur pa sakrificë.

"Liria nuk na erdhi si dhuratë, ajo u fitua me përpjekje, me dhimbje dhe me gjak. Është rezultat i përkushtimit të patriotëve, dijetarëve dhe luftës heroike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të mbështetur fuqishëm nga aleatët tanë ndërkombëtarë si SHBA-ja, NATO-ja dhe partnerët tanë të lirisë", është shprehur Kryetari Ahmeti.



Kryetari Ahmeti theksoi gjithashtu rëndësinë që qyteti i Lipjanit i ka dhënë përjetësisht të figurave emblematisht të rezistencës kombëtare. "Në këtë përvjetor të 26-të të Çlirimit, ndiejmë krenari që qytetin tonë e nderon prania e shtatoreve të figurave të mëdha të lirisë dhe qëndresës, si shtatorja e Komandantit Legjendar Adem Jashari, si dhe ato të Ismet Asllanit, Arsim Zeqirit, Ruzhdi Shabanit, Haredin Bajramit dhe Xhavit Kozhanit", ka thënë Kryetari Ahmeti.

Në përmbyllje të fjalës së tij, Kryetari Ahmeti shprehu zotimin institucional për vazhdimin e përkujdesjes ndaj historisë së lavdishme të popullit tonë, përmes projekteve konkrete që planifikohen të realizohen:

-Parku i Dëshmorëve dhe Martirëve

-Shtatorja e Presidentit Historik, Dr. Ibrahim Rugova

-Kulla-Muze e Veteranëve të UÇK-së

Kujtesa nuk është thjesht përkujtim, ajo është një obligim moral dhe atdhetar për të ndërtuar një shoqëri më të drejtë, më demokratike dhe më të bashkuar.

Urime Dita e Çlirimit, Lipjan!

Lavdi e përjetshme për të gjithë ata që dhanë jetën për lirinë e Kosovës!

Gëzuar 26 vjet liri!

Koncert festiv në nder të Ditës së Çlirimit të Komunës së Lipjanit



Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e Ditës së Çlirimit të Komunës së Lipjanit, në sheshin "Adem Jashari" u mbajt koncert festiv me një atmosferë të veçantë, ku performoi ansambli i mirënjohur "Pjetër Bogdani" nga Krumë-Has, Republika e Shqipërisë. Ansambli solli në skenë një program të pasur artistik me motive nga trashëgimia jonë kulturore dhe folklorike, duke ngjallur emocione dhe duartrokitje nga të pranishmit.

Një nga momentet më prekëse të mbrëmjes ishte interpretimi i këngës kushtuar dëshmorëve të Komunës së Lipjanit, një çast që preku zemrat e publikut dhe rikujtoi me krenari sakrificën e atyre që dhanë jetën për liri.

Në shenjë respekti dhe mirënjohjeje, në emër të Kryetarit të Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ansambli "Pjetër Bogdani" iu dorëzua Simboli i Komunës së Lipjanit si vlerësim i veçantë për interpretimin emocionues të këngës kushtuar dëshmorëve të Lipjanit, si dhe për kontributin e çmuar në ruajtjen dhe promovimin e vlerave tona kombëtare.

Ky aktivitet u mbështet nga Komuna e Lipjanit – DKRS dhe u implementua nga Qendra e Rinisë – Lipjan LYC.



Komuna e Lipjanit dhe organizata “Kosova – Women 4 Women” shpërndajnë pajisje për gratë e certifikuar në hortikulturë



Komuna e Lipjanit, në bashkëpunim me organizatën “Kosova - Women 4 Women”, ka realizuar shpërndarjen e pajisjeve të ndryshme në fushën e hortikulturës për 20 gra që kanë përfunduar me sukses programin e trajnimit dhe certifikimit.

Në këtë ceremoni morën pjesë Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, së bashku me Kryesuesin e Kuvendit, z. Daut Azemi, si dhe Drejtorin për Ekonomi dhe Zhvillim, z. Valon Pacolli.

Me këtë rast, Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, përgëzoi gratë për angazhimin dhe arritjet e tyre gjatë trajnimit, duke theksuar rëndësinë e përkrahjes institucionale për forcimin e rolit të gruas në zhvillimin socio-ekonomik të komunës.

“Përgëzoj të gjitha gratë pjesëmarrëse për certifikimin dhe përkushtimin e treguar. Komuna e Lipjanit mbetet e përkushtuar për t’i mbështetur gratë përmes pajisjeve dhe resurseve që do t’i ndihmojnë të nisin dhe zhvillojnë bizneset e tyre në fushën e hortikulturës. Ky është një shembull i qartë i bashkëpunimit tonë për fuqizimin e gruas në ekonomi,” tha Nënkryetari Bytyqi.

Ai gjithashtu falënderoi organizatën “Kosova - Women 4 Women” për mbështetjen e vazhdueshme në iniciativat që synojnë fuqizimin ekonomik të grave dhe nxitjen e pjesëmarrjes së tyre aktive në sektorin e bujqësisë. Ky aktivitet paraqet një hap të rëndësishëm drejt zhvillimit të qëndrueshëm bujqësor dhe përfshirjes më të gjerë të grave në ndërmarrësi dhe aktivitete ekonomike në Komunën e Lipjanit.



Komuna e Lipjanit ka shënuar 14 Qershor, Ditën e Dëshmorëve, përmes një sërë aktiviteteve përkujtimore, në nderim të atyre që dhanë jetën për lirinë dhe të ardhmen e vendit.



Aktivitetet filluan me homazhe pranë shtatores së Komandantit Legjendar Adem Jashari, ku së bashku me familjarë të dëshmorëve, bashkëluftëtarë dhe përfaqësues të institucioneve vendore, u kujtua me respekt dhe përulësi sakrifica sublime e bijve dhe bijave të Komunës së Lipjanit. Nën patronatin e Kryetarit të Komunës, z. Imri Ahmeti, në Sallën e Kuvendit u organizua Akademia Përkujtimore në nderim të 14 Qershorit, Ditës së Dëshmorëve, e cila shërbeu si një moment reflektimi për të kaluarën tonë të lavdishme dhe për obligimin që kemi ndaj saj në ndërtimin e së ardhmes.

Në fjalën e tij para të pranishmëve, Kryetari Ahmeti theksoi rëndësinë e kësaj date për të gjithë qytetarët e Lipjanit dhe më gjerë.

"14 Qershori nuk është një ditë e zakonshme. Është një ditë kur zemra dhe mendja na shkojnë te ata që sakrifikuuan gjithçka për një të ardhme më të mirë për ne. Ata që nuk e deshën luftën, por nuk pranuan robërinë. Ata që nuk kërkuan asgjë për vete, por na lanë gjithçka, na lanë lirinë", tha Kryetari Ahmeti.

Ai gjithashtu shprehu shqetësimin për përpjekjet që historia të shtrembërohet apo të harrohet, duke theksuar rëndësinë e edukimit të brezave të rinj me ndjenjën e kujtesës kombëtare:

"Borxhi ndaj tyre nuk shlyhet me fjalë. Ai kërkon përkushtim për një shtet që funksionon me arsim cilësor, me shëndetësi dinjitoze, me ekonomi që u jep të rinjve arsye për të qëndruar këtu. Me udhëheqje që bashkon dhe ndërton, e jo që përçan dhe shkatërron", ka theksuar Kryetari Ahmeti.

Në përmbyllje të fjalës së tij, Kryetari Ahmeti bëri të ditur se do të vazhdojë të investojë në projekte përkujtimore konkrete si:

Monumenti i Dëshmorëve dhe Martirëve të Komunës së Lipjanit, ku do të skaliten me nder emrat e atyre që ranë për këtë tokë, si një thirrje për çdo brez.

"Mos e ndërtoni të ardhmen duke harruar të kaluarën!", theksoi ai.

Lavdi e përjetshme dëshmorëve tanë!

Respekt dhe mirënjohje të thellë për familjet e tyre, për veteranët dhe për të gjithë ata që i shërbyen lirisë!

Kryetari Ahmeti nderon me homazhe dëshmorin Ibrahim Krasniqi



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, ka bërë homazhe dhe ka vendosur buqetë me lule pranë varrit të dëshmorit të kombit, Ibrahim Krasniqi, në fshatin Smallushë, në nderim të përvjetorit të rënies së tij, ku njëkohësisht u bë edhe përvjetorimi i pllakës përkujtimore.

Me këtë rast, kryetari Ahmeti theksoi rëndësinë e ruajtjes së kujtimit për dëshmorët si një vlerë të përhershme të identitetit dhe lirisë sonë.

“Sakrifica e dëshmorëve është gurthemel i lirisë që gëzojmë sot. Kujtimi për ta është obligim moral dhe institucional, por edhe frymëzim për të ndërtuar një shoqëri më të drejtë dhe më të bashkuar. Nderimi për jetën dhe veprën e tyre na obligon të punojmë çdo ditë për zhvillimin, mirëqenien dhe të ardhmen e vendit tonë,” tha kryetari z. Imri Ahmeti. Lavdi e përhershme për të gjithë ata që ranë për liri!


Komiteti për Komunitete ka zhvilluar punimet e mbledhjes së 39-të me radhë



Në sallën e takimeve të Komunës së Lipjanit, u mbajt mbledhja e 39-të e Komitetit për Komunitete (KK), e udhëhequr nga kryesuesi, z. Skender Bikliqi, ku u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës.

Gjatë takimit, zyrtari kryesor financiar paraqiti informata lidhur me organizimin e dëgjimeve për kornizën afatmesme buxhetore të Komunës së Lipjanit, për planifikimin e buxhetit 2026-2028. Ndërsa përfaqësuesit e Zyrës Lokale për Komunitete informuan të pranishmit lidhur me raportin e punës së ZKKK-së.

Në përfundim të mbledhjes, anëtarët e Komitetit shqyrtuan disa çështje dhe kërkesa të ndryshme që kanë pranuar nga komunitetet.



Komuna e Lipjanit, në bashkëpunim me organizatën IADK, ka përmbyllur me sukses trajnim me fokus fuqizimin e grave, përmes aftësimit në përdorimin e rrjeteve sociale dhe programeve kompjuterike.

Ky trajnim kishte për qëllim të ndihmojë gratë pjesëmarrëse në zhvillimin e aftësive digjitale, të cilat janë të domosdoshme për një përfshirje më të madhe në tregun e punës, për zhvillimin e bizneseve të vogla, si dhe për vetë-promovim profesional.

Kryetari Ahmeti mban takim publik me qytetarët



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka mbajtur takim publik me qytetarët, me qëllim të prezantimit të punëve të realizuara gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025, si dhe për të dëgjuar nga afër kërkesat dhe propozimet e tyre lidhur me investimet dhe zhvillimin në komunë. Gjatë takimit, Kryetari Ahmeti vlerësoi trendin pozitiv në realizimin e të hyrave vetanake, ku deri më tani janë realizuar 56.40% e planifikimit vjetor. Veçanërisht u theksua realizimi i tatimit në pronë, i cili ka arritur në 53.52%, duke shënuar një rritje prej 19.34% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

“Realizimi i përgjithshëm i të hyrave vetanake është rritur për 25% krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2024, që dëshmon për një performancë të qëndrueshme dhe menaxhim efektiv të buxhetit komunal,” tha Kryetari z. Imri Ahmeti.

Sa i përket projekteve kapitale, aktualisht janë në proces disa projekte, ku një pjesë e tyre është duke u zbatuar në terren, ndërsa të tjerat ndodhen në fazat e procedurave të tenderimit dhe përzgjedhjes së operatorëve, me pritshmëri që shumë shpejt të fillojnë punimet.

Kryetari Ahmeti theksoi se Komuna e Lipjanit, falë qeverisjes transparente, është shpallur fituese e Grantit të Performancës nga DEMOS, përmes të cilit ka siguruar mjete shtesë për projekte të reja. Këto projekte tashmë janë në fazën e tenderimit dhe pritet që së shpejti të nisin zbatimin në terren.

Gjithashtu ai potencoi se përveç investimeve në infrastrukturë, prioritet i veçantë do t’u kushtohet edhe sektorëve të arsimit, shëndetësisë, bujqësisë, sportit, kulturës dhe rinisë, për të cilët janë realizuar projekte konkrete dhe do të vazhdohet me mbështetje të vazhdueshme në funksion të përmirësimit të jetës së qytetarëve.

Qytetarët e pranishëm në takim shprehën mirënjohje për angazhimin e Kryetarit Ahmeti dhe kabinetit të tij për realizimin e projekteve të shumta që kanë ndikuar pozitivisht në zhvillimin e komunës. Ata gjithashtu paraqitën kërkesa për investime të reja kapitale në të ardhmen.

Në përmbyllje të takimit, Kryetari Ahmeti falënderoi të gjithë pjesëmarrësit dhe ritheksoi rëndësinë e komunikimit të drejtpërdrejtë me qytetarët si pjesë thelbësore e qeverisjes së hapur, gjithëpërfshirëse dhe transparente në shërbim të qytetarëve.

KPF mban mbledhjen e 38-të me radhë



Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), i udhëhequr nga Kryesuesi i Kuvendit z. Daut Azemi, ka mbajtur mbledhjen e 38-të me radhë, ku kanë diskutuar të gjitha pikat e rendit të ditës të propozuara për këtë mbledhje.

Anëtarët e KPF-së pas diskutimeve, kanë rekomanduar të gjitha pikat për shqyrtim dhe aprovim në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet të hënën, më 30 qershor 2025

U mbajt mbledhja e 43-të me radhë e Kuvendit të Komunës së Lipjanit



Kuvendi i Komunës së Lipjanit, i udhëhequr nga Kryesuesi, z. Daut Azemi, zhvilloi punimet e mbledhjes së 43-të me radhë, ku u shqyrtuan dhe u miratuan pikat e rendit të ditës, të cilat ishin propozuar për këtë seancë.

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, gjatë kësaj seance ka dhënë sqarime për të gjitha pyetjet dhe çështjet e ngritura nga anëtarët e Kuvendit.

Gjatë punimeve të kësaj seance u miratuan këto pika të rendit të ditës:

- Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 42-të e Kuvendit.
- Propozim Vendim mbi aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028
- Propozim Vendim për ndryshimin e emërimit të Shkollës së Mesme Profesionale "Adem Gllavica".
- Propozim Vendim për formimin e Komisionit përzgjedhës ad.hoc për përzgjedhjen e drejtorëve e zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo arsimore të Komunës së Lipjanit.
- Propozim Vendim për anulimin e Vendimit 15nr.352/05-27004 i dates 29.05.2025 dhe caktimin e lokacionit të varrezave në fshatin Qylagë.





Komuna e Lipjanit – Zyra për informim



<https://lipjan.rks-gov.net/>



infokomuna.lipjan@rks-gov.net



0 800 14 000 / 038 200 41 508